



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GAZETARISË DHE KOMUNIKIMIT



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Gazetari**

Lënda : EPISTEMOLOGJI KOMUNIKIMI

<i>Pedagogu:</i>	Prof. dr. Artan Fuga
<i>Ngarkesa:</i>	5 ETCS (15 javë: 2 leksione dhe 1 seminar në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	E detyrueshme
<i>Viti/semestri:</i>	II/I

Përshkrimi: Lënda trajton koncepte filozofike dhe epistemologjike të komunikimit masiv dhe të mediave parë nga pikëpamja evolutive në historinë e mendimit, por edhe e trajtimeve të sotme të epistemologjisë postmoderne. Tematika trajtohet në rrafshin e përgjithshëm, si edhe në specifikat që konceptet epistemologjike marrin në fushat specifike të komunikimit dhe medias.

Temat e leksioneve:

Leksioni i parë : Epistemologjia dhe specifikat e saj në gazetari dhe në shkencat e komunikimit.

Leksioni i dytë : Faktet dhe kuptimi i tyre epistemologjik. Teoria pozitiviste mbi faktin. Fakti dhe interpretimi i tij. Teoria e Karl. Popperit mbi falsifikimin e dijeve.

Leksioni i tretë : Fakti dhe interpretimi i faktit në shkencë dhe në informacionin masiv.

Raportimi sasior dhe statistikor i ngjarjeve dhe fakteve. Filozofia e numrit të shkollat pitagoriane. Metodologjia dhe epistemologjia e interpretimit të të dhënave numerike në media dhe komunikim.

Leksioni i katërt : Dyshimi dhe besimi. Dyshimi kartezian dhe siguria epistemologjike. Kalimi nga Dekart, te Kanti dhe te Niçja.

Leksioni i pestë : Cilat dije dhe burime informacioni janë të besueshëm ? Burimet e informacionit në media dhe komunikim. Specifikat e verifikimit të burimeve të informacionit në mediat on line.

Leksioni i gjashtë : Koncepti i idealeve dhe objektivitetit. Idealiteti dhe objektiviteti në filozofinë e Platonit. Miti i shpellës. Në çfarë kuptimi perceptimet e objekteve janë « hije » të botës reale. Perceptimi dhe imagjinata.

Leksioni i shtatë : Objektiviteti dhe subjektiviteti i raportimit të ngjarjeve dhe fakteve në komunikimin masiv. Sa është i vërtetë dhe sa iluzor objektiviteti i lajmit?

Leksioni i tetë : Fenomenologjia e Edmond Husserlit mbi marrëdhëniet midis subjektivitetit dhe objektivitetit. « Thjeshtëzimi fenomenologjik i botës. » Si krijohen gjykimet mbi informacionin masiv dhe natyra e përshkrimeve ndijore.

Leksioni i nëntë : Perceptimi dhe vetitë ndijore të realitetit. Kuptimi subjektiv i perceptimeve nga ana e Xhorxh Berklit.

Leksioni i dhjetë : Skepticizmi si metodologji e gazetarit investigativ. Kuptimi i agnosticizmit dhe i skepticizmit në epistemologji. Interpretimi kantian i mundësive të njohjes njerëzore. Hapësira si intuit e njohjes të botës.

Leksioni i njëmbëdhjetë : Bota si tërësi vlerash. Kultura dhe vlerat e një qytetërimi. Vlerat dhe hierarkia e vlerave në gazetari. Trajtimi i konceptimit « vlera » nga ana e Frederik Nices.

Leksioni dymbëdhjetë : Historia dhe historicizmi. Mundësia dhe realiteti në histori. Si e sotmja prodhon të djeshmen në histori? Kuptimi i Henri Bergsonit mbi kohën dhe historinë.

Leksioni i trembëdhjetë : Historia në media. Mekanizmat e mediatizimit të historisë. Kujtimet dhe dëshmitari historik në media dhe në informacionin masiv.

Leksioni i katërbëdhjetë : Kuptimi mbi qenien dhe asgjënë në epistemologji. Lëvizja dhe qetësia. A ekziston substanca e fakteve dhe e ngjarjeve ? Shkollat eleate mbi qenien dhe lëvizjen. Kuptimi i fakteve sociale si përfaqësim simbolik i realitetit. Kuptimi i konceptit rregull dhe kaos në epistemologjinë bergsoniane.

Leksioni pesëmbëdhjetë : Mediat sociale dhe komunikimi në Internet. Kuptimi i ri epistemologjik i të shprehurit në mediat sociale. Individualizimi i gjuhës në Internet dhe gjuha e urrejtjes. Liria e të shprehurit në Internet. Transparenca dhe privatësia sipas epistemologjisë të Wittgenstejnit – çfarë ekuilibri midis tyre?

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- Detyrim frekuentimi seminareve	
- Vlerësimi i dijeve të marra në seminare:	20%
- Vlerësimi i dijeve të marra mnëpërmjet kontrollit të ndërmjetëm:	30% e notës
- Kontrolli përfundimtar:	50% e notës
- Gjithsej:	100%

Literatura e detyrueshme për studentin

Jeanne Hersch, *Habija filozofike*, Dituria, Tiranë 2014

Bill Kovaç, Tom Rosenstiel, *FLU*, Instituti shqiptar i komunikimit, Tiranë

Artan Fuga, *Komunikimi në shoqërinë masive*, Papirus, Tiranë 2014

Literatura plotësuese:

Karl Popper, *Mjerimi i Historicizmit*, Onufri, Tiranë